3. Operatori ekonomik ofertues të mos ketë detyrime për taksat vendore për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e zhvillimit të tenderit nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat detyrimisht duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shënohen datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të mallrave. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore të shitjes, (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat).

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje autorizimi distributori, operatori ekonomik duhet të paraqesë një letër angazhim ose akt marrëveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

- c) Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.
- e) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen standarde kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara (*të pasqyruara në Shtojcën Nr.9 Specifikimet Teknike*), duhet të paraqesë deklaratë konfirmimit të prodhuesit ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.
- f) Operatorët Ekonomikë pjesmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) copë në paketim origjinal për secilin prej produkteve objekt i këtij prokurimi sipas ofertës teknike.
 - Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
 - Mostra duhet të jetë për të gjithë artikujt e kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
 - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

1. Kapele me strehë. Duhet të jetë e pajisur me rrip të rregullueshëm me kapëse plastike dhe me pjesë ballore të përforcuar. Ajo duhet të jetë me material prej pambuku, me strehë si dhe me mundësinë për t'u regjistruar sipas madhësisë së kokës.

2. Helmetë sigurie për mbrojtjen e kokës. Kaska të jetë e prodhuar nga polietilen i injektuar me densitet të lartë, me skelet të rehatshëm plastik dhe tokëz të rregullueshme (minimalisht 54-62 cm). Kaska e sigurisë të jetë e projektuar dhe prodhuar për të siguruar mbrojtje optimale nga objekte të tilla si dhera, gurë, pllaka, tulla dhe sende të tjera të peshës të ngjashme, si dhe nga shkarkimet elektrike deri në 1000V ose 1500Vdc. Kaska të ketë strehë në mes dhe ulluk për kullimin e ujit përreth gjithë perimetrit. Pjesa e brendshme e kaskës të përmbajë minimumi gjashtë rripa për mbrojtje të ndërthurur në formë ylli. Kaska të përmbajë një rrip për t'u lidhur anës mjekrës, dhe mbrojtëse për qafën. Mbrojtëset e kokës në pjesën e brendshme të jenë të mbështjella me një pëlhurë për të thithur djersën. Rripi që lidhet anës mjekrës të përshtatet minimalisht në dy pozicione. Rezistenca ndaj të nxehtit të variojë nga -10 ° C deri + 50 ° C. Peshë: jo më shumë se 0.320 kg. Të jetë konform Standarteve Shqiptare të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 397:2012+A1:2012 dhe SSH EN 50365:2002 ose ekuivalentet e tyre.

3. Helmetë Saldimi. Helmata e saldimit duhet të sigurojë një mbrojtje efektive kundër çdo grimce inkandeshente që mund të çlirohet gjatë proceseve saldimit. Duhet të jetë prej materiali polipropilen, e lehtë dhe fleksibile. Të jetë me ekran që mbulon fytyrën dhe qafën e përdoruesit, duke e mbrojtur atë nga çdo djegie e mundshme. Korniza të jetë e pajisur me një zgavër drejtkëndëshe ku është vendosur okuliti i përbërë nga qelqi joaktinik që mundëson shikimin gjatë punës. Të jetë e çertifikuar sipas standartit europian EN 175 ose ekuivalente.

4. Helmetë sigurie për mbrojtjen e kokës për punimet në lartësi. Helmata e sigurisë të jetë e projektuar dhe prodhuar për të siguruar mbrojtje optimale për punë në lartësi. Helmata të jetë e prodhuar nga material ABS, me skelet të rehatshëm plastik dhe tokëz të rregullueshme (minimalisht 54-62 cm). Helmata të ketë skeletin amortizues minimumi me 6 pika montimi, mekanizëm për rregullimin e madhësisë. Të jetë e pajisur me shirit për ndalimin e djersës në pjesën e ballit dhe minimumi me 4 pika (stili Y). Të jetë konform Standarteve Shqiptare të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 397:2012+A1:2012 dhe SSH EN 50365:2002 ose ekuivalentet e tyre.

5. Syze mbrojtëse transparente. Të kenë kontur me dizajn në formë lente me hark. Syzet të jenë me peshë të lehtë dhe të ofrojnë përputhje totale të syrit dhe të ketë bishta elastik që realizojnë mbrojtje ndaj goditjeve Të jenë konform standartit europian EN 166, ose ekuivalente.

6. Syze transparente për mbrojtje ndaj kimikateve. Syze të jenë me material policarbonat, transparente, me ventilim indirekt për ajrosje dhe kundër verbimit të avullit. Materiali i lenteve të jetë aëtat ose produkt ekuivalent, i cili është shumë i përshtatshëm gjatë përdorimit të kimikateve. Të kenë strukturë PVC fleksible, llastik material tekstil. Të jenë konform standartit europian EN 166 ose ekuivalente.

7. Maskë kundër pluhurit me valvol. Maska të jetë e rehatshme në formë kupe. Të jetë e pajisur me valvul frymë-nxjerrëse për frymëmarrje më të lehtë. Të ketë kapëse hunde të rregullueshme për përputhjesa më ideale. Të ketë hapësirë të madhe të brendshme për të ndihmuar frymëmarrje më të lehtë. Të jetë e përshtatshme për t'u përdorur gjatë gjithë dites. Të jetë konform standartit europian EN 149 ose ekuivalente.

8. Maskë respiratore profesionale kundër gazrave, për mbrojtje gjatë proceseve të punës

për shërbimin DDD. Të jetë në formë gjysëm maske, komode dhe me dy gryka me përbërje polipropileni (PP). Të jetë e prodhuar nga material TPE i butë dhe jo alergjik. Të jetë e pajisur me 2 fishekë filtri A2 dhe me rripat elastikë. Të sigurojë mbrojtje maksimale ndaj gazeve, avujve etj. Maska të jetë konform standartit european EN 140 ose ekuivalente.

9. Filtër për maskë respiratore profesionale kundër gazrave. Këto filtra të jenë në përputhje të plotë me stansartet dhe përmasat për zëvendësim në maskën respiratore kundër gazrave për punonjesit e DDD (artikulli nr.8). Filtrat të jenë konform standartit european EN 143 ose ekuivalente.

10. Jelek me logo, me shirita fosforishente. Ngjyra të jetë portokalli ose e verdhë. Materiali i jelekut duhet të jetë 100% polyester, pesha 120g-130g. Jeleku të ketë të stampuar në shpinë dhe në pjesën e përparme në krahun e majtë logon e institucionit sipas modelit që do të këkohet nga autoriteti kontraktor. Duhet të Lahet në lavatriçe. Të jetë minimum me dy shirita horizontal reflektues. Të jetë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 20471:2013 ose ekuivalente.

11. Kominoshe verore me logo. Duhet të përbëhen nga poliester dhe minimumi 35% pambuk. Materiali të jetë 100% antitkurrës dhe të ketë mbajtje të mirë të ngjyrës. Materiali të jetë i përbërë nga fije të gjata pambuku të qelëndrueshme në formë rrethore, që të mundësojë rezistencë ndaj pushavitjeve dhe përshtatshmëri komode me trupin. Kominoshet të jenë të llojit trup pa mëngë, me dy pjesë të përparme dhe të pasme. Të kenë minimumi 4 xhepa ku dy xhepa të jenë në pjesën ballore të pantallonave dhe 2 xhepa në pjesën mbrapa pantallonave. Kominoshet të mbyllën me zinxhir të dyanshëm në pjesën e përparme, dhe gjithashtu të kenë mbyllje me llastik në mes në pjesën e shpinës për përshtatje sa më të mirë me trupin. Pjesa e belit të jetë elastike. Duhet të ketë të stampuar logon e institucionit sipas modelit që do të kërkohet nga autoriteti kontraktor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

12. Kominoshe me mëngë me logo. Materiali duhet të përbëhet nga poliester dhe minimumi 35% pambuk. Materiali të jetë 100% antitkurrës dhe të ketë mbajtje të mirë të ngjyrës. Materiali të jetë i përbërë nga fije të gjata pambuku të qëndrueshme në formë rrethore, që të mundësojë rezistencë ndaj pushavitjeve dhe përshtatshmëri të mirë me trupin. Kominoshet të jenë te llojit trup me mëngë, me dy pjesë të përparme dhe të pasme. Të kenë minimumi 4 xhepa ku dy xhepa të jenë në pjesën ballore të pantallonave dhe 2 xhepa në pjesën mbrapa pantallonave. Kominoshet të mbyllën me zinxhir të dyanshëm në pjesën e përparme, dhe gjithashtu të kenë mbyllje me llastik në mes në pjesën e shpinës për përshtatje sa më të mirë me trupin. Pjesa e belit të jetë elastike. Duhet të ketë të stampuar logon e institucionit sipas modelit që do të kërkohet nga autoriteti kontraktor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

13. Përparëse për sanitare verore. Duhet të jenë me gjatësi mesatare dhe mëngë të shkurtra me mbyllje të përparme me kopsa, të ketë minimumi 3 (tre) xhepa në pjesën e përparme. Ngjyra të jetë e hapur. Materiali të përbëhet nga 100 % pambuk. Duhet të ketë të stampuar logon e institucionit sipas modelit që do të kërkohet nga autoriteti kontraktor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

14. Përparëse për sanitare dimërore. Duhet të jenë me gjatësi mesatare dhe mëngë të shkurtra me mbyllje të përparme me kopsa, të ketë minimumi 3 (tre) xhepa në pjesën e përparme. Ngjyra

të jetë e hapur. Materiali të përbëhet nga 100 % pambuk. Duhet të ketë të stampuar logon e institucionit sipas modelit që do të kërkohet nga autoriteti kontraktor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

15. Veshje speciale një përdorimëshe për DDD. Duhet të jenë rezistente ndaj agjentëve kimikë me të cilët është duke punuar specialisti i DDD dhe t'i japë atij rehati duke ndihmuar performancën e tij gjatë proceseve të aplikimit të lëndëve kimike. Të jenë me mbyllje me zinxhir ose ngjitëse dhe ngjyra të bardhë. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 13034:2005+A1:2009 ose ekuivalente.

16. Kominoshe pune profesionale për DDD. Kominoshe me mëngë, të gjata, ngjyrë të bardhë, Duhet të përbëhen nga material durues ndaj lëndëve kimike. Kominoshet duhet të jenë me minimumi 2 xhepa ballorë, me mbyllje me zinxhir ose ngjitëse. Kominoshet të kenë qepje të dyfishtë. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN ISO 13982-1:2004/A1:2010 ose ekuivalente dhe/ose konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 13034:2005+A1:2009 ose ekuivalente.

17. Bluzë verore, me mëngë të shkurtra. Të jetë e përbërë 100% nga pambuku, me peshë specifike minimumi 150 gr/m². Bluza të jetë me jakë rrumbullake dhe me qepje të dyfishtë tek mëngët dhe pjesët fundore. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Bluza duhet të jetë e çertifikuar me standartin europian Oeko Tex ose ekuivalente.

18. Mushama shiu. Të jetë me përbërje 100 % poliester e veshur me PVC, të jetë ideale për kushte të lagështa, e pajisur me kapuç. Gjatësia deri në pjesën gjurit. Të ketë xhepa të mëdhenj dhe material që ventillohet. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 343:2019 ose ekuivalente.

19. Doreza plastike të thjeshta për sanitare. Duhet të jenë të përshtatshme për punën e sanitareve. Dorezat të jenë me ngjyrë të hapur ose të tejdukshme. Materiali PE. Përmasa M-XXL. Kjo dorezë të jetë prodhuar nga një material rezistent dhe shumë të rehatshëm, duke bërë të mundur përdorimin sa më të lehtë dhe pa rrezik çarje të menjëhershme në kontakt me inertet.

20. Doreza profesionale doku për punë. Këto doreza mbrojtëse shërbejnë për punë të përgjithshme. Dorezat të jenë me pjesën e shpites të ashpër dhe të ofrojnë për përdoruesit mbrojtjen e duhur dhe komoditetin gjatë kapjes të çdo materiali. Të kenë një përbërje me dendësi të lartë të copës duke bërë të mundur një mbrojtje maksimale nga mjetet e forta. Të jenë shumë të rehatshme dhe komode për shkak të elasticitetit dhe përbërjes. Materiali: Pambuk/PVC. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 388:2016+A1:2018 ose ekuivalente.

21. Doreza saldatori prej lëkure. Dorezat të jenë cilësore të përforcuara tek gishti i madh dhe pëllëmba. Doreza prej lëkure duhet të mundësojë mbrojtje gjatë proceseve të punës në lidhje me nxehtësinë. Të jetë ideale për saldimit, mbajtje metalesh etj. Të ketë mbrojtje maksimale nga djegiet. Materiali lekurë. Të ketë mbushje të plotë me pambuk të butë dhe të rehatshëm. Të jenë konform standartit europian EN 407 ose ekuivalente.

22. Doreza anti-prerje. Doreza të jetë e veshur me një shtresë PU dhe lesh xhami për të mundësuar komformitetin dhe sigurinë në punë të veçanta që paraqesin rrezik prerje. Doreza të jetë me nivelin C anti-prerje për mbrojtje kundër prerjeve dhe objekteve të mprehta. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 388:2016+A1:2018 ose ekuivalente dhe konform standartit ANSI/ISEA 105 - 2016 CUT Level (A3) ose ekuivalente.

23. Doreza profesionale kundër kimikateve për DDD. Dorezë me veshje të dyfishtë PVC me pjesën e shputës të ashpërsuar për një kapshmëri efikase që të ofrojë për përdoruesit mbrojtjen e duhur dhe rezistente ndaj kimikateve. Të jenë të çertifikuara për të ofruar mbrojtje kundër kimikateve. Sipërfaqja tek shputat të jetë anti-rrëshkitje dhe të ofrojë zhdërvjelltësi të lartë në kushte të lagështa dhe të thata. Të jenë konform Standarteve Shqiptare të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 388:2016+A1:2018 dhe SSH EN ISO 374-1:2016/A1:2018 ose ekuivalentet e tyre.

24. Doreza të gomuar për DDD. Dorezat të jenë tek pjesa e shputës e ashpërsuar që të ofrojnë për përdoruesit mbrojtjen e duhur dhe rezistente ndaj kimikateve. Të jenë të çertifikuara për të ofruar mbrojtje kundër kimikateve. Siperfaqja tek shputat të jetë anti-rrëshkitje dhe të ofrojë zhdërvjelltësi të lartë në kushte të lagështa dhe të thata. Të jenë ultra të ndjeshme dhe pa proteina të tretshme që ndihmojnë në minimizimin e rrezikut të reaksionit alergjik. Materiali pambuk, nitril. Trashësia të jetë jo më pak se 0.38mm. Të jenë konform Standarteve Shqiptare të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 388:2016+A1:2018 dhe SSH EN ISO 374-1:2016/A1:2018 ose ekuivalentet e tyre.

25. Çizme të thjeshta. Ngjyra e zeze/jeshile; Materiali PVC; PVC nitrile; Rezistente ndaj nxehtësisë; Rezistente ndaj vajrave; Rezistente ndaj acideve/alkalineve; Rezistente ndaj rrëshqitjes. Madhësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN ISO 20347:2012 ose ekuivalente.

26. Çizme qafë gjatë. Ngjyra e zezë/jeshile; Materiali PVC; PVC nitrile; Rezistente ndaj nxehtësisë; Rezistente ndaj vajrave; Rezistente ndaj acideve/alkalineve; Rezistente ndaj rrëshqitjes. Madhësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN ISO 20347:2012 ose ekuivalente.

27. Çizme kundër kimikateve. Ngjyra e bardhë. Çizmet duhet të jenë të përshtashme për punonjësit e DDD për përdorim profesional, të domosdoshme gjatë procesit të dezinfektimit, dezinfektimit etj. Madhësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Duhet të jenë të realizuara me material PVC, rezistente ndaj acideve/alkalineve me nivel mbrojtës S4.

28. Këpucë pune me qafë. Këpucët e punës me qafa të prodhuara me boks vici, të padepërtueshme nga lagështia, me ngjyrë të zezë, me lidhëse, me shoje gome tip traktori me ngjitje me vullkanizim. Materiali i suprinës të jetë boks viçi, cilësi e parë, jo poroz, e papërshkueshme nga uji, me trashësi jo më të vogël se 1,6 mm. Shollë gome kompakte e presuar me element dizenjo për mosrrëshqitje. Goma kundra vajrave, produkte të naftës, etj. Fundi (sholla) të jetë me gome kompakte. Bombeja (maja ku takojnë gishtrinjtë) dhe forteja (pjesa e

thembrës), të ketë majë Çeliku për mbrojtjen e gishtërinjëve nga goditjet deri në 200 joules (xhaul) dhe shtypje deri në 15kN. Sholla e gomës të jetë kompakte e dhëmbëzuar. Të ngjitet me tabanin, fjaqen me faqet me ngjitës me dy komponente. Madhësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN ISO 20345:2011 ose ekuivalente.

29. Këpucë për skelë S3. Të jenë këpucë të lehta dhe komode për punë, me majë mbrojtëse për të mbrojtur gishtat ndaj goditjeve apo rënive të sendeve të rënda aksidentalisht. Shualli të jetë me sistem amortizues dhe anti rreshqitjes. Madhësia sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Të jenë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN ISO 20345:2011 ose ekuivalente.

30. Pajisje sigurie për punime në lartësi. Duhet të jetë me thurje poliesteri, dhe e lehtë në përdorim. Nëpërmjet rripave të tij ai mbron punëtorin nga rënia në lartësi. Të jetë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 363:2018 ose ekuivalente.

31. Çantë për mbajtje vegla pune. Kjo çantë të jetë e përshtatshme për t'u mbajtur nga punëtorët gjatë riparimeve, për të vendosur veglat e punës. Ajo duhet të jetë e përbërë nga material rezistent dhe funksionale për të bërë të mundur jo vetëm sistemimin por dhe transportimin e veglave. Pra duhet të jetë e përbërë nga disa nënhapësira për organizim dhe e lehtë për t'u mbajtur, jo më e rëndë se 1.2 kg, dimensione, jo më të vogla se 42 cm gjatësi, 32 cm gjerësi dhe 58 cm lartësi.

32. Kutë për ndihmën e shpejtë. Kutia e ndihmës së shpejtë të jetë për përdorim në rast të nevojave për mjekime të lehta nga dëmtimet gjatë proceseve të punës dhe ndihmon të trajtohet një emergjence në një moment aksidenti. Kutia përfshin minimalisht: doreza, shirit ngjitës, fasho trekëndësh, fasho elastike, pastrues për dëmtime të lëkurës, fasho për djegie, garza standarte, kompresa për plagë, një palë gërshërë.

33. Jelek me mbushje pa mëngë me logo. Veshja jashtme e jelekut duhet të jetë material rezistent ndaj erës dhe veshja e brendshme duhet të jetë 100% pambuk kurse pjesa e jashtme pambuk ose poliestër. Mbërthimi i jelekut duhet të jetë me zinxhir. Materiali mbushës duhet të jetë i tillë që të termoizolojë pjesën e trupit, për të ruajtur maksimalisht ngrohtësinë e tij. Jeleku duhet të ketë minimalisht 3 (tre) xhepa në pjesën e jashtme dhe në anën e pasme të tij të ketë logon e institucionit. Stampim duhet të jetë serigrafik full color e logos së institucionit, ndërsa emri i institucionit të jetë i stampuar me fosfor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

34. Bluzë dimri për punë. Materiali të jetë i përbërë nga poliestër dhe minimumi 50% nga pambuku, me mëngë të gjata. Bluza duhet të jetë e çertifikuar me standartin Oeko Tex ose ekuivalente. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

35. Rrip sigurimi për mesin. Të jetë me mekanizëm përshtatje sipas përmasave trupore. Rripi të ketë gjithashtu pjesën kapëse për mjetet me të cilat mund të lidhet. Të jetë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 358:2018 ose ekuivalente.

36. Litar rrip sigurimi me amortizues. Duhet të jetë me thurje poliester dhe i lehtë në përdorim. Nëpërmjet lidhjes së tij me rripin e sigurimit për mesin dhe strukturës fikëse të ndërtimit ai mbron punëtorin nga rënia në lartësi. Gjatësia 1.5 deri në 2m. Të jetë konform Standartit Shqiptar të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit SSH EN 355:2002 ose ekuivalente.

37. Xhup pune dimëror me logo. Xhupi të jetë me mëngë të gjata me logo të autoritetit kontraktor. Materiali i xhupit duhet të jetë poliester ose pambuk dhe brenda duhet të jetë i mbushur me pambuk. Stampimi duhet të jetë serigrafik full color e logos së institucionit, ndërsa emri i institucionit të jetë i stampuar me fosfor. Madhësia nga M-XXL sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

38. Brezore për mbajtjen e veglave të punës. Brezorja e veglave të punës të jetë një mjet me cilësi të lartë, të jetë e pajisur me xhepa të shumta dhe unazore çeliku për në vendin e çekiçit të punës. Pajisja duhet të vendoset dhe fiksohet mjaft lehtë në rripin e mesit për të realizuar një kompatibilitet të plotë me veshjen. Materiali: Poliester. Përmasat: 36-38cm x 6-7cm x 28-30cm ose përmasa të tjera të përafërta që sigurojnë kompatibilitet të produktit sipas kërkesave teknike.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i Mallrave	Njësia	Sasia
1	Kapele me strehë	copë	90
2	Helmetë sigurie për mbrojtjen e kokës	copë	94
3	Helmetë sigurie për saldim	copë	2
4	Helmetë sigurie për mbrojtjen kokës për punime në lartësi	copë	6

Dokumentat Standarde të Tenderit

5	Syze mbrojtëse transparente	palë	66
6	Syze transparente për mbrojtjen ndaj kimikateve	palë	8
7	Maskë kundra pluhurit me valvol	copë	78
8	Maskë respiratore profesionale kundër gazrave për mbrojtje gjatë proceseve të punës për shërbimin e DDD	copë	2
9	Filter per Maskë respiratore profesionale kundër gazeve	copë	46
10	Jelek i hollë veror me logo	copë	290
11	Kominoshe verore me logo	palë	123
12	Kominoshe me mëngë me logo	palë	123
13	Përparëse për sanitare verore me logo	copë	6
14	Përparëse për sanitare dimërore me logo	copë	6
15	Veshje speciale një përdorimshe për DDD	palë	310
16	Kominoshe për punë profesionale DDD me logo	palë	2
17	Bluzë verore	copë	155
18	Mushama shiu	copë	60
19	Doreza plastike të thjeshta për sanitare	palë	400
20	Doreza profesionale doku për punë	palë	140
21	Doreza saldatori	palë	4
22	Doreza anti prerje	palë	23
23	Doreza profesionale kundër kimikateve	palë	2
24	Doreza të gomuara për DDD	palë	13
25	Çizme të thjeshta	palë	52
26	Çizmet qafë gjata	palë	15
27	Çizme kunder kimikateve	palë	2
28	Këpucë pune me qafë	palë	35
29	Këpucë për skelë S3	palë	15
30	Pajisje sigurie për punime në lartësi	copë	4
31	Çanta për vegla pune	copë	30
32	Kuti për ndihmën e shpejtë	copë	10
33	Jelek me mbushje pa mëngë me logo	copë	135
34	Bluzë dimri për punë	copë	135
35	Rrip sigurimi mesi për punime në lartësi	copë	20

Dokumentat Standarde të Tenderit

36	Litar rrip sigurimi me amortizues	copë	24
37	Xhup pune dimëror me logo	copë	65
38	Brezore për vegla	copë	30

Afatet e lëvrimet: **Në kohë dhe sasi sipas kërkesave të autoritetit Kontraktor deri në 30(tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Shtojca 11

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër*]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		

...		
-----	--	--

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Dokumentat Standarde të Tenderit

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe

regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime

në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
